

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6774
E hënë, 5 dhjetor 2022
çmimi 0.40

(Për vizitën e presidentit Begaj në Vatikan)

Vizitë e rëndësishme dhe sjellje e dinjitetshme

FAQE 6

Agim VINCA



Në ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPOZITA, KRITIKA PËR BUXHETIN E VITIT 2023

FAQE 4



Përfaqësuesit e partive opozitare të PDK-së, të LDK-së dhe të AAK-së kanë theksuar se buxheti për vitin 2023 është buxheti më jotransparent që ka pasur Kosova. Sipas tyre, buxheti 3 miliardë e 212 milionë euro nuk adreson nevojat e qytetarëve dhe sfidat me të cilat po

ballafaqohet vendi. Opozita thekson se ky buxhet është bërë pa asnjë konsultim paraprak me komunitat dhe qytetarët. Ndërkaq kryeministri Albin Kurti ka nisur takimet nëpër komuna duke prezantuar para qytetarëve buxhetin për vitin 2023

AKTUALE



OSMANI: TË MIRATOHEN NDRYSHIMET KUSHTETUESE, JANË KUSHT PËR NË BE F. 2


BE-ja I BËN PRESION SERBISË PËR SANKSIONET KUNDËR RUSISË

F. 5

POLICIA DHE INSPEKSIONI NË PRISHTINË NË AKSION KUNDËR TAKSIVE ILEGALE F. 6



EKONOMI



TRENI FUSHË-KOSOVË - HAN I ELEZIT PRITET TË RINISËT ME NJË VIT VONESË F. 8

SPORT



ANGLIA ELIMINON SENEGALIN, GJEN NË ÇEREKFINALE FRANCËN F. 10

PDK-ja BËHET ANËTARE ME TË DREJTA TË PLOTA NË ALDE

FAQE 3



KËRKOHEM MBËSHTETJE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
E-mail: renova@mt.net.mk
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Osmani: Të miratohen ndryshimet kushtetuese, janë kusht për në BE

SHKUP, 4 DHJETOR - Ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, u bëri thirrje partive politike që sa më shpejt t'i miratojnë ndryshimet kushtetuese të cilat janë kusht për integrim në Bashkimin Evropian.

Maqedonia e Veriut, më 19 korrik, formalisht ka nisur bisedimet me Bashkimin Evropian, por bisedimet thelbësore për kapitujt nuk do të fillojnë pa ndryshimin e Kushtetutës maqedonase për përfshirjen e pakicës bullgare në të.

Kjo parashihet me marrëveshjen me Bullgarinë, bazuar në propozimin francez për zgjidhjen e kontesteve mes dy vendeve lidhur me çështjet historike, gjuhën dhe identitetin maqedonas. "Tema e ndryshimeve kushtetuese duhet të hapet sa më shpejt në Kuvend. Partitë politike duhet që të arrijnë një konsensus për çështjet evropiane dhe të arrijnë një marrëveshje që kushdo qoftë në pushtet, të mos

ketë dallime për këtë çështje", ka deklaruar kryediplomati Osmani më 4 dhjetor, duke theksuar se është gabim të mendosh se po negociojmë me Bashkimin Evropian. "Rregulloret dhe direktivat janë të fiksuara. Ju duhet t'i pranoni ato ashtu siç janë për t'u bërë anëtare e BE-së. Pavarësisht nëse është LSDM [Lidhja Socialdemokrate në pushtet], BDI [Bashkimi Demokratik për Integrim në pushtet] apo VMRO DPMNE [partia më e madhe opozitare maqedonase], askush nuk ka mundësi të ndryshojë diçka në negociatat me Bashkimin Evropian. E vetmja gjë që mund të ndryshojë është dinamika e dorëzimit dhe pranimit", shtoi Osmani duke bërë me dije se pa ndryshimet kushtetuese nuk mund të flitet për integrimin e Maqedonisë së Veriut në BE.

Ai ka thënë se kjo temë përfundimisht duhet të mbyllet sepse, sipas tij, qytetarët, pavarësisht se cilës prejardhje politike i përkasin, duan anëtarësimin në BE. "Nëse nuk



ka dallime, atëherë pse të mos e lëmë anash këtë temë, në interes të qytetarëve që duan BE në të dyja anët e skenës politike. Kemi mjaft tema për të

diskutuar", ka theksuar Osmani. Pavarësisht thirrjes të shefit të diplomacisë, Bujar Osmani, VMRO-ja opozitare ka thënë se nuk do t'i mbështesë

ndryshimet kushtetuese pasi pretendon se marrëveshja me Bullgarinë është e dëmshme për interesat kombëtare dhe shtetërore maqedonase.

Raporti i ri thotë se Kina ka mbi 100 stacione policore në mbarë botën

PEKIN, 4 DHJETOR - Pekini ka ngritur më shumë se 100 të ashtuquajtura stacione policore në mbarë botën për të monitoruar, frikësuar dhe në disa riatdhesuar shtetasit kinezë që jetojnë në mërgim. Kjo është bërë përmes marrëveshjeve dypalëshe të sigurisë të arritura me shtete në Evropë dhe Afrikë me qëllim që të ketë një prani më të gjerë ndërkombëtare, thuhet në një raport të cilin e posedon CNN.

Organizata e të drejtave të njeriut, Safeguard Defenders (Mbrotjtësit e Sigurisë), me seli në Madrid, tha se gjeti prova se Kina po operonte 48 stacione shtesë policore jashtë vendit, që kur kjo organizatë për herë të parë zbuloi në shtator ekzistencën e 54 stacioneve të tilla.

Raporti i ri përqendrohet në shkallën e rrjetit dhe shqyrton rolin që kanë luajtur nismat e përbashkëta policore midis Kinës dhe disa shteteve evropiane, përfshirë Serbinë, Kroacinë, Rumaninë dhe Italinë.

Sipas pretendimeve të reja të kësaj organizate, thuhet se një shtetas kinez u detyrua që të kthehej në shtëpi nga operativët që punonin fshehurazi në një stacion policor kinez në periferi



të Parisit. Operativët thuhet se ishin rekrutuar për këtë qëllim. Më herët organizata gjeti se dy kinezë në mërgim dhe të tjerë ishin kthyer me forcë nga Evropa - njëri nga Serbia, tjetri nga Spanja.

Kina ka nënshkruar marrëveshje për patrullime të përbashkëta policore me Kroacinë dhe Serbinë ndërmjet viteve 2018 dhe 2019 si pjesë e nismës së saj "Brezi dhe Rruga".

Oficerët kinezë janë parë duke patrulluar me homologët e tyre kroatë në rrugët e Zagrebit në korrik të këtij viti, kanë raportuar mediet kineze. Ndërkaq, një zyrtar policor i Zagrebit ka thënë për agjencinë "Xinhua" se patrullat ishin thelbësore "për të mbrojtur dhe për të tërhequr

turistë të huaj".

Ndërkaq, sipas një raporti të vitit 2019 nga agjencia "Reuters", thuhet se oficerët kinezë u ishin bashkuar homologëve të tyre serbë në patrullim në Beograd për të adresuar rritjen e numrit të turistëve kinezë. Një zyrtar policor serb kishte deklaruar se zyrtarët kinezë nuk kanë fuqinë që të bëjnë arrestime.

Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë njoftoi më 4 dhjetor se nuk është në dijeni për informacionet se Kina ka stacione policore në Serbi. "Ne theksojmë se bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit midis Ministrisë së Brendshme të Serbisë dhe Ministrisë për Siguri Publike të Republikës Popullore të Kinës, sa i përket zbatimit të

patrullave të përbashkëta policore, që është nënshkruar më 19 maj të vitit 2019, gjashtë policë kinezë kanë qenë prezentë në patrullat e përbashkëta të policëve serbë dhe kinezë vetëm për një muaj, nga 17 shtatori deri më 16 tetor të vitit 2019", u tha në njoftim. Kjo ministri nuk iu përgjigj pyetjeve të Radios Evropa e Lirë të dërguara më 30 tetor, për të konfirmuar apo mohuar ekzistencën e stacioneve policore kineze në Serbi, siç kishte raportuar organizata "Safeguard Defenders" në raportin e parë të publikuar në shtator të këtij viti. Sipas raportit të "Safeguard Defenders", Kina po i përdor këto rrjete policore për t'i bindur disa banorë të saj të kthehen në Kinë, edhe pa vullnetin e tyre që, sipas të dhënave zyrtare kineze, mund të bëhet fjalë për çerek milion kinezë në mbarë botën, që kur Xi Jinping ka marrë pushtetin në Kinë. "Ajo çfarë po shohim nga Kina është rritje e përpjekjeve për ta shtypur disidencën gjithkund në botë, për t'i kërcënuar njerëzit, për t'i ngacmuar ata, për t'u siguruar që t'i frikësojë mjaftueshëm sa të qëndrojnë të heshtur ose në të kundërtën përballen me kthim në Kinë,

kundër vullnetit të tyre", tha drejtoresha e "Safeguard Defenders", Laura Harth.

Që nga publikimi i parë i kësaj organizate në shtator lidhur me këtë temë, ka pasur reagime në shumë shtete.

Muajin e kaluar, drejtori i Byrosë Federale të Hetimeve (FBI), Christopher Wray, tha para një komiteti të sigurisë kombëtare se ishte thellësisht i shqetësuar me gjetjet. "Është shqetësuese të mendosh që policia kineze mund të ngrehë stacione, le të themi në Nju-Jork, pa një koordinim të mirëfilltë. Kjo shkel sovranitetin dhe proceset për bashkëpunim mes institucioneve të rendit", tha ai.

Irlanda ka mbyllur një stacion policor kinez që e ka gjetur në territorin e saj, ndërkaq Holanda ka ndërmarrë masa të ngjashme duke nisur një hetim, sikurse ka bërë edhe Spanja.

Harth nga "Safeguard Defenders" tha se ka të ngjarë që organizata të gjejë edhe më shumë stacione të tilla në të ardhmen. "Kina nuk po fsheh atë që po bën. Ata shprehimisht thonë se do t'i zgjerojnë këto operacione, prandaj le t'i marrim seriozisht" këto deklarata, tha ajo.

Kërkohet mbështetje për personat me aftësi të kufizuara



PRISHTINË, 4 DHJETOR - Fëmijët me aftësi të kufizuara janë në mesin e personave që pranojnë më së paku burime dhe shërbime, tha ambasadori i Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Sznunuyog, në Ditën Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara. "Ne të gjithë duhet të bëjmë më shumë për t'i mbështetur që t'i shprehin aftësitë e tyre dhe të zënë vendin e merituar si të barabartë në shoqëri", tha Sznunuyog në "Twitter". Në Ditën Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara, Sznunuyog bëri thirrje që të gjithë të

bashkohen, "që ta bëjnë Kosovën një shoqëri përfshirëse për të gjithë fëmijët". Përfaqësues të organizatave joqeveritare në Kosovë që merren me mbrojtjen e të drejtave të kësaj kategorie, edhe sivjet kërkuan nga autoritetet kompetente në Kosovë që t'i zbatojnë ligjet për këtë kategori të shoqërisë. Në shënim të kësaj ditë, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim Komitetin Paralimpik të Kosovës dhe organizatën e studentëve Handicap. Në këto takime Osmani shprehu mbështetjen, duke theksuar se "objektiv i përditshëm" është

gjithpërfshirja e tyre në shoqëri, punësimi dhe jeta e dinjitetshme. Ajo njoftoi se do të ndajë 100 000 euro shtesë subvencione për organizatat që mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Viti i personave me aftësi të kufizuara

Ndryshe, me një vendim të Qeverisë së Kosovës, viti 2022 është shpallur "Viti i personave me aftësi të kufizuara". Në bazë të këtij vendimi institucionet obligohen që gjatë vitit 2022 të plotësojnë kuotën e punësimit në bazë të

Ligjit për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuara. Inspektorati i Punës, në anën tjetër, obligohet për inspektimin e zbatimit të këtij ligji. Por, punësimi mbetet ende problemi kryesor. Vetëm 99 persona që punojnë në institucionet publike të Kosovës janë me aftësi të kufizuara - nga mbi 83 mijë sa është numri i përgjithshëm i të punësuarve në këtë sektor. Me ligjin në Kosovë, sektori publik dhe ai privat janë të obliguar që të punësojnë një person me aftësi të kufizuara në çdo 50 punëtorë.

Në bazë të kësaj, i bie që institucionet publike do të duhej të kishin të punësuar mbi 1 600 persona me aftësi të kufizuara.

Institucionet nuk i paguajnë obligimet

Probleme, megjithatë, nuk duket se ka vetëm me punësimin. Institucionet publike nuk i paguajnë as obligimet materiale që kanë ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Në bazë të Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, në rast se punëdhënësi nuk i përmbush detyrimet për punësimin e kësaj kategorie, ai duhet të ndajë në një xhirollogari të veçantë pagesat mujore - me vlerën e pagës minimale - për çdo person me aftësi të kufizuar që do të duhej ta kishte të punësuar. Këto para, pastaj, do të shfrytëzoheshin për projekte të ndryshme, me qëllim të përgatitjes së personave me aftësi të kufizuara për treg të punës. Vlera e pagës minimale në Kosovë aktualisht është 130-170 euro.

Inspektorati i Punës në fund të muajit qershor ka thënë për Radion Evropa e Lirë se deri më tani asnjë institucion publik nuk i ka bërë pagesat për "shkaqe teknike", por nuk specifikojnë më shumë. Nëse rast se nuk përfundohen këto obligime, ligji kërkon që punëdhënësi të ndëshkohet me gjobë nga 500 deri në 2 000 euro.

PDK-ja bëhet anëtare me të drejta të plota në ALDE

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) është bërë anëtare me të drejta të plota e grupit më të madh politik të partive liberale të Evropës, ALDE.

Në mbledhjen e dytë vjetore të Këshillit të Partisë Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve të Evropës (ALDE), të mbajtur në Bratislavë të Sllovakisë, anëtarët kanë votuar pa asnjë votë kundër për pranimin e PDK-së.

Parimet themelore liberale të lirisë, demokracisë, shtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut, tolerancës dhe solidaritetit janë vlerat që promovojnë partitë politike që qëndrojnë nën ombrellën e ALDE-s, e të cilat PDK-ja i ka si mision për t'i zbatuar edhe në Kosovë.

Krasniqi i cili po merr pjesë në mbledhjen e dytë vjetore të Këshillit të ALDE-s në Bratislavë, ka thënë se pranimi i PDK-së në këtë grup politik po vjen si

finalizim i një procesi tejet të rëndësishëm për PDK-në. "Ky është një hap i madh drejt përqafimit të vlerave evropiane dhe rikonfirmim i njohjes së reformave thelbësore që PDK-ja ka bërë gjatë këtij viti. Një PDK e hapur dhe gjithëpërfshirëse, me vizion 50/50 për përfaqësim gjinor në të gjitha strukturat dhe nivelet e vendimarrjes, me rini të fuqizuar dhe aktive, si dhe e integruar në rrjetin e partive liberale evropiane, është plotësisht në funksion të forcimit dhe demokratizimit të vendit dhe shoqërisë sonë!", ka thënë Krasniqi.

Anëtarësimi me të drejta të plota në ALDE vjen pas pranimin në Rrjetin Liberal të Evropës Juglindore (LIBSEEN) më 14 maj, pjesëmarrjes së kryetarit Krasniqi në kongresin e ALDE-s në Dublin të Irlandës në qershor të këtij viti, ku shprehi aspiratën e PDK-së për pranim në këtë parti dhe vizitës studimore që byroja e ALDE-s e realizoi në Prishtinë në mes të tetorit.





Opozita, kritika për buxhetin e vitit 2023

Përfaqësuesit e partive opozitare të PDK-së, të LDK-së dhe të AAK-së kanë theksuar se buxheti për vitin 2023 është buxheti mëjotransparent që ka pasur Kosova. Sipas tyre, buxheti 3 miliardë e 212 milionë euro nuk adreson nevojat e qytetarëve dhe sfidat me të cilat po ballafaqohet vendi. Opozita thekson se ky buxhet është bërë pa asnjë konsultim paraprak me komunat dhe qytetarët. Ndërkaq kryeministri Albin Kurti ka nisur takimet nëpër komuna duke prezantuar para qytetarëve buxhetin për vitin 2023

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Ish-zëvendëskryeministri Besnik Tahiri, aktualisht shef i grupit parlamentar i AAK-së, ka theksuar se buxheti i vitit 2023 është miratuar në qeveri pa asnjë konsultim paraprak me komunat dhe qytetarët. Ndërkaq, sipas tij, prezantimi nëpër komuna është mashtrim i ulët që u bëhet qytetarëve. “Në esencë janë tri probleme: E para, në mungesë të rezultateve, qeveria ka nisur t’i prezantojë buxhetet edhe të komunave, kur dihet se buxheti komunal është i rregulluar si financim i rregullt, llogaritur 10 për qind e buxhetit të shtetit në grantin e përgjithshëm, ai për arsim dhe shëndetësi. E dyta, se kjo qeveri edhe po cenon përditë pavarësinë e komunave me akte arbitrare, si ai për grabitjen e të hyrave vetjake por, njëkohësisht, paturpësisht po sillet si një organizatë humanitare, që këta u dhanë

kaq miliona komunave, ndërkaq çdo projekt i madh investiv nga qendra është shkurtuar dhe nuk ka ndodhur asnjë konsultim për to. E treta, nëse qeveria do të donte t’i ndihmonte komunat dhe shërbimet më të mira, nuk do ta hiqte nga agjenda legislative miratimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, ku parashihej financimi i shërbimeve sociale, por edhe mjetet që po mbaheshin nëpër ministri, ku do të shpenzoheshin në zhvillim”, ka thënë Tahiri. Ai i ka bërë thirrje qeverisë që të mos bëjë lojë numrash sa i përket buxhetit. “Qeveri, mos bëj lojë numrash me qasjen se ky është buxheti me i madh ‘historik’, sepse është vetëm aq sa është reflektuar inflacioni, asgjë më pak e asgjë më shumë”, ka thënë Tahiri.

Ish-ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Hykmete Bajrami, e cila aktualisht është deputete e Lidhjes Demokratike të Kosovës, ka thënë se buxheti që ka prezantuar qeveria Kurti për

vitin 2023 është buxheti mëjotransparent. “Ky është buxheti më jotransparent që ka ardhur ndonjëherë për aprovim në Kuvend, marrë parasysh faktin se rreth 271 milionë euro janë të ndara në Ministrinë e Financave dhe Transfereve, janë si kontigjenca dhe fonde për ringjallje ekonomike. D.m.th., 271 milionë euro fonde pa projekte, pa plan, vetëm janë aty që, nëse dështojnë ministrinë e linjës, superministri i Financave për dy minuta me kreativitetin e tij është në gjendje t’ua shpërndajë qindra miliona euro taksa të qytetarëve”, ka thënë Bajrami.

Ajo ka theksuar se ky buxhet nuk adreson nevojat e qytetarëve dhe sfidat me të cilat po ballafaqohet vendi. “Është buxhet politik, komunat që LV-ja nuk ka mundur t’i marrë me votë po mundohet t’i mund me buxhet. Vetëm një shembull: Derisa projektet kapitale nga niveli qendror për komunën e Shtimes kapin shumën mbi 7.5 milionë euro, projekte të tilla

për komunën e Lipjanit janë me pak se 1.9 milion euro. Në ndërkohë që qeveria, pa kurrfarë arsytimi, është tërhequr nga ndryshimi i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, që e ka brenda grantin kapital që do t’i pamundësonte shpërndarjet e tilla politike të buxhetit. Besoj se qëllimet janë të qarta. Në kundërshtim me dy ligje: Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, qeveria në mënyrë arbitrare me këtë ligj dëshiron që fondet vetjake të komunave t’i marrë dhe t’i trajtojë si suficit për rishpërndarje. Këtë nuk do ta lejojmë”, ka thënë deputetja Bajrami.

Ndërkaq koordinatori i Departamentit për Financa në Kabinetin për Qeverisje të Mirë, Arben Mustafa, ka kritikuar qeverinë Kurti për mungesë vizioni në hartimin e buxhetit për vitin 2023. Mustafa ka thënë se ky buxhet nuk i reflekton kërkesat e qytetarëve të Kosovës në ekonomi, krijim të vendeve të punës dhe ngritje të kualitetit të jetës. “Ky buxhet më së shumti mund të quhet një kopje e dobët e vitit 2022, sepse në shumicën e rasteve është një përsëritje e vitit 2022. Këtij buxheti i mungon ambicia zhvillimore, i mungon

orientimi se ku do të jetë Kosova në fund të vitit 2023, se çfarë Kosove do të kemi në fund të vitit 2023”, ka thënë ai.

Kryeministri Albin Kurti ka nisur takimet nëpër komuna duke prezantuar para qytetarëve buxhetin për vitin 2023. Ai në këto takime po shoqërohet nga ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati dhe ministri i Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi.

Me 64 vota të deputetëve është miratuar buxheti 3.2 miliardësh për vitin 2023. “Buxheti për vitin 2023 do të jetë 3 miliardë e 212 milionë euro, kurse të hyrat buxhetore do të arrijnë vlerën prej 2 miliardë e 884 milionë eurosh, me ç’rast kemi ndarë 745 milionë euro në kategorinë ‘Paga dhe mëditje’, 493 milionë euro në kategorinë ‘Mallra dhe shërbime’, 1 miliard e 98 milionë euro në ‘Subvencione dhe Transfere’ dhe 811 milionë euro në ‘Shpenzime kapitale’. Falënderoj secilin deputet dhe secilën deputete që përmes votës së tij dhe të saj i dha sot mbështetje në lexim të parë buxhetit për vitin e ardhshëm që reflekton prioritetet e programit qeverisës e nga i cili përfitojnë qytetari dhe republika”, pati deklaruar Kurti me rastin e votimit të buxhetit nga deputetët.

BE-ja i bën presion Serbisë për sanksionet kundër Ruisisë

Prishtinë, 4 dhjetor - Presioni i Bashkimit Evropian ndaj Serbisë është duke u rritur për shkak të refuzimit të Beogradit për t'i mbështetur sanksionet ndaj Ruisisë, thonë diplomatët evropianë.

Nga koha kur Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës në muajin shkurt, BE-ja ka shprehur qartë pritjet që vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat synojnë integrimin në BE, t'i mbështesin qëndrimet e këtij blloku, duke i përfshirë edhe sanksionet kundër Ruisisë për shkak të pushtimit të Ukrainës.

Serbia deri tash i ka injoruar këto thirrje dhe kjo, si duket, e ka rritur zemërimin e disa vendeve anëtare të BE-së. Për pasojë, thonë disa burime diplomatike në Bruksel, "praktikisht është ngrirë edhe procesi i negociatave të anëtarësimit të Serbisë në BE". Kjo dëshmohet edhe me faktin se, për më shumë se një vit, Serbia nuk ka

hapur apo mbyllur asnjë kapitull në procesin e negociatave. Për hapjen apo mbylljen e tyre duhet pajtım i të gjitha vendeve anëtare të BE-së. Dhe, disa vende, thonë diplomatët, "nuk duan që Serbia të shpërblehet me vazhdimin e procesit të anëtarësimit në BE, sikur të mos ketë ndodhur asgjë".

Edhe Parlamenti Evropian, përmes një rezolute për strategjinë e re të zgjerimit, ka kërkuar që të kushtëzohen negociatat e anëtarësimit të Serbisë në BE me mbështetjen e sanksioneve kundër Ruisisë. Presioni pritet të rritet edhe gjatë muajit dhjetor, kur në Tiranë do të mbahet një samit i BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Në deklaratën që pritet të miratohet atje do të përsëritet thirrja për mbështetje të sanksioneve ndaj Ruisisë.

Në draftin e deklaratës që ka parë Radio Evropa e Lirë nuk

përmendet ndonjë vend me emër, por besohet se bëhet fjalë për Serbinë e cila nuk i ka mbështetur ende sanksionet e Bashkimit Evropian kundër Ruisisë. "Përderisa thellojmë bashkëpunimin tonë me partnerët, kërkojmë nga ta që të bëjnë përparim të shpejtë dhe domethënës drejt përshtatjes së plotë me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, si dhe të veprojnë në përputhje me këtë, përfshirë edhe me masat restriktive të BE-së", thuhet në draft-deklaratën që pritet të miratohet në samitin e 6 dhjetorit.

Serbia në atë samit, paralajmërojnë diplomatët, "do të jetë pak a shumë e izoluar, pasi është i vetmi shtet pjesëmarrës që nuk i ka vendosur sanksione Ruisisë".

Zhënjimi i disa vendeve të BE-së me Serbinë pritet të jetë edhe më i qartë në disa konkluzë që do të miratohen për procesin e

zgjerimit dhe të stabilizim-asociimit më 13 dhjetor nga Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së.

Sipas draftit të konkluzave që kanë përgatitur vendet e BE-së, pritet të shprehet "shqetësim i thellë" për "ecjen prapa" që ka bërë Serbia për përshtatjen e qëndrimeve të saj me ato të BE-së sa iu takon çështjeve të politikës së jashtme dhe të sigurisë.

Në draft-konkluzë, BE-ja shpreh "pritje të fuqishme" nga Serbia që t'i përmbushë obligimet e marra në kuadër të kornizës negociuese me BE-në, si dhe ta forcojë përshtatjen e saj me politikën e BE-së, përfshirë edhe sanksionet kundër Ruisisë.

Po ashtu, pritet që ky këshill i BE-së ta mirëpresë faktin se Qeveria e re e Serbisë e ka cilësuar integrimin në BE si qëllim strategjik, por se do të kërkohej që kjo të ndiqet edhe me veprime konkrete. "Sidomos

në kontekstin e agresionit luftarak të Ruisisë kundër Ukrainës, këshilli pret nga Serbia që të dëshmojë përkushtim të palëkundur ndaj BE-së dhe të angazhohet për parimet dhe vlerat tona të përbashkëta", thuhet në draft-konkluzë.

Sipas burimeve diplomatike, Bashkimi Evropian nuk mendon të ndër marrë hapa formale për pezullimin e negociatave të anëtarësimit me Serbinë, por është i vetëdijshëm se negociatat nuk ka gjasa reale të vazhdojnë derisa Serbia nuk u bashkohet sanksioneve të Perëndimit kundër Ruisisë.

Nga Serbia, vendet e BE-së presin të mos lejojnë anashkalimin e sanksioneve kundër Ruisisë përmes territorit të saj. Serbia prej vitesh negocion anëtarësimin në BE, por në të njëjtën kohë bashkëpunon edhe me Rusinë në disa fusha, përfshirë mbrojtjen.



Policia dhe Inspeksioni në Prishtinë në aksion kundër taksive ilegale

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Drejtoria e Inspeksionit në Prishtinë, nën asistimin edhe të Policisë së Kosovës, është duke zhvilluar një aksion kundër taksive ilegale në pika të ndryshme të kryeqytetit. Përmes një komunikate për medie, kjo drejtori ka

njoftuar se taksitë ilegale po shkaktojnë probleme të mëdha në mbarëvajtjen e komunikacionit në kryeqytet. "Drejtorja e Inspeksionit, nën asistimin edhe të Policisë së Kosovës, është duke zhvilluar një aksion kundër taksive ilegale në pika të ndryshme të

kryeqytetit, të cilët, përveç problemeve të mëdha që po shkaktojnë në mbarëvajtjen e komunikacionit në kryeqytet, paraqesin edhe rrezik potencial për sigurinë e qytetarëve të cilët i shfrytëzojnë për qarkullim", ka njoftuar Drejtoria e Inspeksionit në Prishtinë.



(Për vizitën e presidentit Begaj në Vatikan)

Vizitë e rëndësishme dhe sjellje e dinjitetshme



Agim VINCA

Në Prishtinë, e as në Tiranë, askush nuk e shtron pyetjen se përse Vatikani nuk e njeh Republikën e Kosovës? As politikanët, as diplomatët, as ministrat e jashtëm, as kryetarët e komisioneve për politikë të jashtme dhe as ministrat e deputetët e tjerë shqiptarë kudo që janë, nuk e prekin fare këtë çështje. Madje, as analistët e shumtë në të dy anët e kufirit që na bombardojnë për çdo natë me "analizat" e tyre "kompetente" për politikën e jashtme e të brendshme, nuk i referohen fare çështjes së (mos)nlohjes së Kosovës nga Vatikani. Heshtin si të mos ekzistonte!

E, kanë kaluar më se 14 vjet nga shpallja e Kosovës shtet i pavarur e sovran më 17 shkurt 2008. Ndërkohë, Kosovën e pavarur e kanë njohur mbi njëqind shtete të botës (kush thotë 117, kush më pak), përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britaninë e Madhe, Francën, Gjermaninë, Italinë etj., ndërsa Vatikani, për çudi (për arsytet që ne s'i dimë; s'kemi si t'i dimë!), nuk po e bën as përçapjen më të vogël në këtë drejtim. (Shteti i fundit që na njohu rreth dy vjet më parë, por me kushte - kusht ishte vendosja e ambasadës së Kosovës në Jerusalem e jo në Tel-Aviv - është Izraeli).

Në këta njëzet e sa vjet nga çlirimi i Kosovës e këndeje në

vizitë te Papa në Romë kanë qenë, pos Ibrahim Rugovës (më se një herë), edhe Hashim Thaçi, Sali Berisha, Fatos Nano, Bujar Nishani, Edi Rama, Isa Mustafa, RamushHaradinaj, Atifete Jahjaga e të tjerë (lista mund të jetë edhe më e gjatë), por askush nga këta, me asnjë fjalë, nuk ka kërkuar nga kreu i Selisë së Shenjtë që ta njohë Republikën e Kosovës si shtet. Kanë bërë dhurata, ftesa për vizitë, kanë folur në përgjithësi për marrëdhënie të mira me Selinë e Shenjtë etj., por çështjen kryesore: atë të njohjes së Kosovës nga Vatikani e kanë heshtur ose anashkaluar!

I pari që po e bën këtë hap, hapur dhe pa hezitim, është Presidenti i posazgjedhur i Shqipërisë (e mori këtë detyrë pak muaj më parë), Bajram Begaj. Gjatë vizitës që i bëri këto ditë Selisë së Shenjtë, ku u prit nga kreu i saj, Papa Françesku i Dytë, Presidenti Begaj, siç njoftohet, i kërkoi mikpritësit, Papa Françeskut, njohjen e Kosovës si shtet nga Vatikani. Këtë e bëri të ditur vetë kreu i shtetit shqiptar në një intervistë për median italiane (në gazetën e njohur "l'Espresso"). Njoftohet gjithashtu se zoti Begaj ka thënë me këtë rast se "roli i Papës është i rëndësishëm për

Ballkanin Perëndimor" dhe se "vëmendja e Papës ndaj Kosovës do ta ndihmonte shumë dialogun Beograd-Prishtinë".

Duke pasur parasysh këtë fakt, sikurse edhe rolin e Selisë së Shenjtë në përgjithësi në botë, këto dy thekse të fjalës së Presidentit shqiptar fitojnë peshë akoma më të madhe. Zoti Bajram Begaj është në fillim të mandatit të tij si president i Republikës së Shqipërisë. Nuk e dimë si do të sillet më vonë dhe sa do të ketë hapësirë për të vepruar, por vizita e tij e parë e rëndësishme jashtë vendit (në Vatikan),

sikurse edhe sjellja e tij dinjitoze në takimin me Kreun e Selisë së Shenjtë dhe, në mënyrë të veçantë, kërkesa për njohjen e Republikës së Kosovës si shtet nga Vatikani paralajmërojnë një fillim të mbarë.

Urojmë që Presidenti Begaj, njeri që në postin e kryetarit të shtetit erdhi nga radhët e ushtrisë (pas një karriere të gjatë e të suksesshme si ushtarak), ta vazhdojë mandatin duke vënë në plan të parë interesat shtetërore e kombëtare e jo duke menduar për karrierën e tij politike, siç kanë vepruar dhe veprojnë shumica e politikanëve shqiptarë.



Ministrja Haxhiu viziton Qendrën "Ri-Jeta" në Ferizaj

FERIZAJ, 4 DHJETOR - Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka vizituar të dielën Qendrën "Ri-Jeta" në Ferizaj.

Gjatë takimit me drejtoreshën Arieta Musliu u njoftua për punën dhe rolin e kësaj qendre. "Takua

shumë nëna me të cilat diskutuam për rëndësinë e veprimeve institucionale për trajtimin e personave të

cilët janë vartës të substancave narkotike", ka shkruar Haxhiu në "Facebook".



Treni Fushë-Kosovë - Han i Elezit pritët të riniset me një vit vonesë

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Rehabilitimi i segmentit hekurudhor Fushë-Kosovë - Han i Elezit pritët të përfundojë në fund të këtij viti, konfirmojnë zyrtarë të "Infrakos"-it, kompanisë që operon rrjetin hekurudhor të Kosovës. Kjo linjë është në riparim e sipër qysh në vitin 2019 dhe, fillimisht, ka qenë e paraparë që punimet të përfundojnë në vitin 2021.

Linja ka vazhduar në drejtim të Maqedonisë së Veriut dhe ka qenë e vetmja që ka lidhur Kosovën me një vend të Ballkanit Perëndimor.

Qarkullimi i trenit në të është ndërprerë në mars të vitit 2020, duke i privuar qytetarët nga një mjet udhëtimi, që konsiderohet më i lirë, kjo pastaj ka shkaktuar probleme financiare edhe për "Trainkos"-in, kompaninë që ofron shërbime për transportin hekurudhor në Kosovë dhe mbledh të hyrat nga shitja e biletave. "Nuk jemi të dëmtuar, por të sakatuar. Disa herë kam kërkuar nga autoritetet kompetente arsyen e mospërfundimit të punëve në infrastrukturën e hekurudhës, por nuk kam marrë përgjigje. Ne kërkojmë që transporti i udhëtarëve dhe mallrave të rifillojë. Kjo po na dëmton shumë në aspektin financiar", thotë Nol Dedaj, kryesues i bordit të "Trainkos"-it për Radion Evropa e Lirë.

Përpara ndërprerjes së qarkullimit të trenit Fushë-Kosovë - Han i Elezit, Dedaj thotë se të ardhurat mesatare vjetore nga shitja e biletave kanë qenë rreth 100 mijë euro. Kjo shumë në vitin 2021 është

zvogëluar në rreth 51 mijë euro, ndërsa gjatë këtij viti në 45 mijë euro, pasi në qarkullim kanë mbetur vetëm trenat Prishtinë - Pejë dhe Prishtinë - Fushë-Kosovë.

Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës i mbështesin, po ashtu, pretendimet për zvogëlimin e numrit të udhëtarëve.

Nga mbi 120 mijë sa ka qenë numri i personave që kanë udhëtuar me tren në vitin 2018, ky numër është zvogëluar në rreth 60 mijë në vitin 2021, tregojnë të dhënat e ASK-së.

Shkaqet e vonesave

Zvarritjet e punimeve lidhen me një varg arsyesh, përfshirë pandeminë e koronavirusit, thonë nga "Infrakos"-i.

Uran Mulaj, ushtrues i detyrës i kryeshefit ekzekutiv në këtë kompani, thotë se vonesa kanë shkaktuar edhe disa mjete të pashpërthyer ekspozive që janë gjetur në trupin hekurudhor e që besohet se datojnë nga luftërat botërore.

Pas sanimit të këtij problemi, ai konfirmon se rehabilitimi i segmentit Fushë-Kosovë - Han i Elezit do të përfundojë në dhjetor.

REL ka kontaktuar edhe kompaninë italiane "Generale Construzioni Ferroviare" (GCF), e cila është zgjedhur nga "Infrakos"-i për kryerjen e punimeve në këtë segment, por deri në publikimin e këtij artikulli nuk ka marrë përgjigje. Punimet në këtë linjë, që kanë përfshirë edhe nënkontraktorë vendorë, kanë kapur vlerën e rreth 78 milionë eurove. Mjetet



janë siguruar kryesisht përmes kredive nga mekanizmat financiarë ndërkombëtarë. Kosova ka nisur rehabilitimin edhe të segmenteve të tjera hekurudhore.

Zyrtarë të "Infrakos"-it bëjnë me dije se në muajin tetor kanë filluar punimet në segmentin Fushë-Kosovë - Mitrovicë, të cilat pritët të përfundojnë në muajin janar të vitit 2024. Kjo linjë do të mund ta lidhë Kosovën me Serbinë.

Zyrtarët, po ashtu, kanë thënë se rrjeti hekurudhor që lidhet me Shqipërinë është në fazën e fizibilitetit, apo vlerësimit të planit. Hekurudhat e Kosovës kanë një gjatësi prej rreth 333 kilometrash dhe trenat e Kosovës dikur kanë qarkulluar edhe në linja ndërkombëtare.

Hekurudhat nuk janë mirëmbajtur siç duhet që nga fillimi i viteve '90, kur edhe kanë filluar luftërat në territorin e

ish-Jugosllavisë dhe degradimi i tyre ka vazhduar pastaj vit pas viti. Shumë stacione trenash janë, po ashtu, në gjendje të rëndë.

Trenat e vjetër

Dedaj, nga "Trainkos"-i, thotë se edhe kur të riparohen hekurudhat, udhëtarët nuk do të kenë kushte më të mira të akomodimit në trena. Kjo pasi, sipas tij, lokomotivat dhe vagonët janë të vjetër dhe nevojiten shpenzime të larta për zëvendësimin e tyre. "Nga shtetet mike jemi duke kërkuar donacione ose makina lëvizëse për udhëtarë dhe mallra në mënyrë që me modernizimin e hekurudhave të ketë edhe trena me shpejtësi më të madhe", thotë Dedaj. Ai nuk dha detaje se nga cilat shtete janë kërkuar donacionet dhe nëse kanë marrë ndonjë përgjigje prej

tyre.

Trenat aktualë nuk mund të lëvizin më shpejt se 60 kilometra në orë, kurse me renovimin e hekurudhave shpejtësia do të mund të rritet ndoshta deri në 150 kilometra në orë.

Në vitin 2018 Qeveria e Kosovës, e udhëhequr asokohe nga kryeministri Ramush Haradinaj, ka premtuar se deri në vitin 2022 Kosova do ta ketë të përfunduar rrjetin hekurudhor Fushë-Kosovë - Han i Elezit dhe Fushë-Kosovë - Leshak në kufi me Serbinë.

Edhe një muaj deri në përfundim të vitit 2022, kjo nuk ka ndodhur.

Zyrtarë të Qeverisë së Kosovës kanë konfirmuar më herët për Radion Evropa e Lirë se janë duke punuar në rrjetin që lidh Kosovën me shtetet e rajonit dhe më gjerë, por se kur do të përfundojnë të gjitha punimet nuk dihet.

Prezantohet buxheti për vitin 2023 para qytetarëve të Gjakovës



GJAKOVË, 4 DHJETOR - Pas komunës së Pejës, kryeministri Albin Kurti bashkë me ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati dhe ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, buxhetin për vitin 2023 e prezantuan të dielën para qytetarëve të komunës së Gjakovës.

Duke qenë buxheti më i lartë dhe më gjithëpërfshirës ndonjëherë, ai tha se gjatë hartimit të tij qeveria është siguruar që ky buxhet të jetë më shumë për të gjithë.

Përpos që më shumë për arsimin, shëndetësinë, bujqësinë e sigurinë, buxheti për vitin e ardhshëm do të jetë më shumë edhe për komunat.

Rreth 100 milionë euro më shumë se këtë vit parashihet të jetë buxheti për komunat e Republikës së Kosovës.

Më shumë se vitin e kaluar është

planifikuar të jetë edhe buxheti për komunën e Gjakovës, i cili pritët të arrijë vlerën prej 31,558,422 eurosh.

Ndër të tjera, për vitin e ardhshëm Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka ndarë 11 milionë euro për zgjerimin e rrugës Dollc - Gjakovë. Mbi 2.5 milionë euro janë planifikuar në fushën e arsimit nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe 1 milion të tjera në fushën e sportit, kulturës dhe trashëgimisë nga ministria përkatëse.

Pas prezantimeve fillestare, kryeministri Kurti së bashku me ministrin Murati dhe ministrin Krasniqi patën rastin të bashkëbisedojnë me qytetarët, duke iu përgjigjur pyetjeve dhe komenteve të tyre mbi ndarjet buxhetore dhe projektet për vitin tjetër.

Kush e zotëron trashëgiminë tonë dixhitale?



Nga Viola STEFANELLO

Rasti i parë në Itali ishte i Karlo Kostancës. Kuzhinieri me origjinë nga Agrixhento nëItalinë Jugore, por i transferuar me banim në Milano për punë, vdiq në moshën 25-vjeçare në një aksident automobilistik në marsin e vitit 2017. Në ngjarjen fatale u shkatërrua edhe Iphone-i i tij.

Në kërkim të kujtimeve që do të ndihmonin “në mbushjen të paktën pjesërisht të ndjenjës sëzbrazëtisë”, prindërit e tij i kërkuan “Apple Italia Srl” që të mund të hynte në llogarinë e iCloud të djalit të tyre, ku ishin sinkronizuar videot, mesazhet dhe aplikacione, shënime dhe kërkime e të ndjerit në internet, pra tërësia e informacionit që sot përbën identitetin dixhital të një njeriu.

Por për të mbrojtur identitetin e palëve të treta që kishin komunikuar me të riun – miq, kolegë, ndonjë partnere – dhe për t’iu përmbajtur parimit të konfidencialitetit të nënshkruar nga “Apple” në momentin e lidhjes së kontratës me klientët,

kompania nuk kishte ndërmend të siguronte prindërve të të ndjerit qasje në iCloud-in e tij, derisa ata të paraqisnin një dokument që i përcaktonte si “përfaqësues të të ndjerit” dhe bartës formalë të një “pëlqimi legjitim”, siç përcaktohet nga akti i privatësisë së komunikimeve elektronike, ose ligji i SHBA që rregullon zbulimi i autorizuar i të dhënave.

Nuk ishte rasti i parë me të cilin u përballën kompanitë e mëdha të teknologjisë. E pari ishte rasti “Ellworth”, që daton në vitin 2003. Në atë kohë, kompania “Yahoo!” ai refuzoi t’i jepte babait të një ushtari 20-vjeçar amerikan, që vdiq në Irak, qasje në e0mailin e djalit të tij. Kompania pretendoi se kërkesa binte në kundërshtim me politikën e saj të konfidencialitetit dhe të sigurisë, të cilat kërkonin të mos ndahej fjalëkalimi i llogarisë me askënd tjetër përveç pronarit. Në atë rast, një gjykatë në Miçigan e urdhëroi kompaninë të lejonte babain të kishte qasje në e-maillet e të birit, duke argumentuar se informacioni dhe të dhënat e llogarisë së e-mailit brenda llogarisë,

duhet të trajtohen si pasuritë të tjera, që kalojnë tek anëtarët e tjerë tëfamiljes në momentin e vdekjes së dikujt. Që nga ajo kohë, sasia e kujtimeve, informacioneve dhe dokumenteve që janë arkivuar në internet është rritur në mënyrë eksponenciale, dhe bashkë me të edhe pritshmëria e njerëzve të afërt me të ndjerin për të pasur qasje në to. Por çështjet e ngritura nga këto lloj rastesh, nuk janë zgjidhur në mënyrë të kënaqshme.

Në Itali, ndjeshmëria për këtë temë duket se ka evoluar në favor të kërkesave të të afërmeve. Në shtatorin e vitit 2006, duke komentuar çështjen “Ellsworth” presidenti i atëhershëm i Autoritetit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, deklaroi në një intervistë për Corriere della Sera se “nuk mund t’i japësh askujt, madje as trashëgimtarëve, qasjen në një e-mail, pasi ai mund të përmbajë të dhëna personale jo vetëm të të ndjerit, por të të gjithë bashkëbiseduesve të tij, ndaj qasja duhet të jetë absolutisht e ndaluar”.

Ajo që e ndryshoi situatën ishte reforma e kodit të privatësisë së vitit 2018, që ndodhi pasi Bashkimi

Evropian miratoi në vitin 2016 Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave të Bashkimit Evropian, që në një seksion thoshte shprehimisht se “rregullorja nuk vlen për të dhënat e personave të vdekur”, duke e lënë në vullnetin e shteteve anëtare miratimin e ligjeve të posaçme mbi këtë çështje.

Pikërisht në këtë kuadër, familja e Karlos u përpoq në vitin 2018 ta paraqesë çështjen në gjykatën civile të Milanos. Nga kjo lëvizje rezultoi një vendim i paprecedentë në Itali, qëhodhi themelet për një sërë gjykimesh të mëvonshme që ka lejuar disa familje vitet e fundit, të kenë qasje në të dhënat e telefonave inteligjentë, kutitë e postës elektronike dhe në profilet sociale të njerëzve të dashur që vdiqën papritur.

Edhe falë dështimit të “Apple”, që nuk u paraqit në seancë, gjykata civile e Milanos vendosi në favor të familjes Kostanca. Ai vendim i hapi rrugën disa rasteve të tjera, në të cilat gjykatat, duke njohur rëndësinë e madhe që ka për familjarët kujtesa për të ndjerin, morën anën e anëtarëve të familjes.

I tillë ishte edhe rasti i gruas

që paditi kompaninë “Apple” në gjykatën civile të Bolonjës në nëntorin e vitit 2021 për të pasur qasje në iPhone-in e djalit të saj adoleshent, që kreu vetëvrasje.

Qëllimi i tij ishte “të rikuperonte fotografitë, videot dhe çdo gjë tjetër që mund të ndodhej në telefon, në mënyrë të tillë që të ishte në gjendje të mbushte, të paktën pjesërisht, ndjenjën e zbrazëtisë, pyetjet pa përgjigje dhe dhimbjen e pamashë të shkaktuar vdekja e parakohshme dhe tragjike e djalit të saj, dhe ndoshta të identifikonte në postimet e tij të fundit shenja për arsytet e veprimit të tij ekstrem.

Në ato rrethana, “Apple” i ofroi asaj një listë të kërkesave ligjore të nevojshme për të fituar qasje në llogaritë e të birit në rrjetet sociale. Gjatë kohëve të fundit, të gjitha kompanit e teknologjisë janë pajisur me mekanizma për ta bërë më të lehtë kalimin e të dhënave tek një trashëgimtar ose e kundërta, për të vendosur fshirjen automatike të të dhënave të tyre në momentin e vdekjes, diçka që mund të njoftohet nga një palë e tretë.

Marrë me shkurtime nga “Essenziale” – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Anglia eliminon Senegalin, gjen në çerekfinale Francën

DOHA, 4 DHJETOR - Anglia është skuadra e katërt që siguron biletën për në çerekfinale të Kupës së Botës, atje ku do të përballet me Francën, në një finale të parakohshme. "Tre Luanët" fituan në shifrat 3-0 ndaj Senegalit, duke konfirmuar një formë shumë të mirë. Skuadra e Southgate vuajti disi në pjesën e parë, derisa do të zhbllokonin rezultatin me Henderson në

minutën e 38-të. Anglia nuk u ndal me kaq, pasi në shtesën e pjesës së dytë do të realizonte dhe golin e dytë me Harry Kane që shfrytëzoi një asistim nga Foden. Nga një kundërsulm perfekt do të vinte dhe goli i tretë. Këtë herë ishte Bukayo Saka që do të shënonte golin e tretë në minutën e 57-të. Pas një paraqitje shumë solide, tashmë prova e radhës e Anglisë do të jetë ndaj Francës,

një duel që do të dhurojë spektakël. Franca ka realizuar fitore ndaj Polonisë me rezultat 3:1 në 1/8 e finales së Kupës së Botës "Katari 2022". Kampionët në fuqi të botës triumfuan me golat e Olivier Giroudit, 44', dhe Kylian Mbappesë, 74', 90+1'. Ndërkaq golin e nderit për polakët e shënoi Robert Lewandowski nga pika e bardhë në minutën e nëntë të lojës shtesë.



Peja vazhdon serinë pozitive, Ylli regjistron fitoren e shtatë radhazi

PEJË, 4 DHJETOR - Peja ka vazhduar me fitore, duke mundur kësaj radhe Bashkimin me rezultat 71:66 (22:16, 18:16, 17:14, 14:20), në xhiron e 13-të në Prince Caffë Superligë. Për verdhezinjtë ishte fitorja e dhjetë, ndërsa kanë edhe dy humbje, kurse prizrenasit kanë katër fitore e nëntë humbje. Vendasit e nisën furishëm ndeshjen me një seri prej 12:1, dhe gjatë gjithë çerekut të parë ishin në epërsi edhe pse me kalimin u zvogëlua paksa, ndërsa kjo pjesë përfundon 22:16. Por, mysafirët nuk u dorëzuan dhe shpejt u rikthyen, duke ngushtuar shifrat në 26:24, kurse në fund të periudhës së dytë mysafirët sërish u



shkëputën, duke shkuar në pushim me shifrat 40:32. Lojë interesante ishte edhe në periodën e tretë, me vendasit që shkëputeshin në epërsi e mysafirët që afruan shifrat në 49:46, por verdhezinjtë në

fund të kësaj pjese ishin më të mirë, ku rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 57:46. Portokallezinjtë sërish u rikthyen në dhjetë e minutat e fundit, ku barazuan shifrat në 60:60 dhe lojë e barabartë u

zhvillua deri në fund, ku pejanët ishin më të vëmendshëm dhe fituan 71:66. Te Peja më të mirët ishin Brad Waldow me dhjetë pikë e 11 kërcime dhe Arti Hajdari me 15 pikë e katër kërcime, kurse te Bashkimi më i miri ishte Fahro Alihoxhiq me 17 pikë e tetë kërcime. Golden Eagle Ylli ka shënuar fitore të thellë ndaj Trepçës me rezultat 86:67 (27:8, 18:21, 23:18, 18:20) në xhiron e 13-të në Prince Caffë Superligë. Për therandasit ishte fitorja e shtatë radhazi pas humbjeve që kishin, kurse mitrovicasit kanë gjashtë fitore e shtatë humbje. Vendasit e nisën në mënyrë fantastike ndeshjen, ku qysh në fillim krijuan

epërsi të lartë, 18:4, ndërsa çerekun e parë e fituan 27:8. Ylli e thelloi edhe më shumë epërsinë në periudhën e dytë, ku më e larta ishte 37:15, por më pas mitrovicasit u këndellën paksa, ku skuadrat shkuan në pushim me shifrat 45:29. Therandasit për një nuancë ishin më të mirë në periodën e tretë, duke mos lënë epërsinë të shkrihej, madje edhe e ngritën atë, ndërsa në dhjetë minutat e fundit zhvillohej lojë me formalitet dhe sfida përfundon 86:67. Te vendasit më i miri ishte Bashir Ahmed me 24 pikë e dhjetë kërcime, kurse te mitrovicasit më i miri ishte Cadarian Raines me nëntë pikë e dhjetë kërcime.

Ballkani shënon fitore bindëse ndaj Llapit në 'Zahir Pajaziti'



PODUJEVË, 4 DHJETOR - Skuadra kampione në fuqi, Ballkani ka shënuar fitore në duel me Llapin, 3-0, në ndeshjen e mbetur të javës së 7-të në Albi Mall Superligën e Kosovës në futboll. Ndeshja në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë nisi me një minutë heshtje në

nderim të futbollistit të ri të FC Trepça'89, Erion Kajtazi, i cili të shtunën ndërroi jetë në fushën e gjelbër pas një sulmi kardiak. Portokallezinjtë e Suharekës e dominuan ndeshjen në Podujevë. Rezultatit e zhbllokoi sulmuesi llapjan në radhët e

Ballkanit, Albion Rrahmani, me golin e shënuar në minutën e 24-t. Epërsinë në 2-0 e shtoi Armend Thaqi, në minutën e 56-të, derisa rezultatin përfundimtar e vulosi Meriton Korenica, tre minuta më vonë. Për Ballkanin kjo ishte fitorja e 11 në këtë edicion në 17

ndeshje të zhvilluara. Ndeshjen e fundit për këtë vit skuadra e Ilir Dajës e zhvillon më 11 dhjetor kundër Prishtinës në Suharekë dhe me fitore eventuale ka mundësi të dimërojë në pozitën e parë, pasi tashmë ka vetëm një pikë më pak se Drita.

Iu dha lamtumira e fundit futbollistit Erion Kajtazi

MITROVICË, 4 DHJETOR - Në fshatin Zasellë të Mitrovicës, të dielën në prani të familjarëve, bashkëlojtarëve, shokëve, trajnerëve e mësimdhënësve, drejtuesve të institucioneve dhe qytetarëve të shumtë, iu dha lamtumira e fundit futbollistit 17-vjeçar të FC "Trepça'89"

dhe Kombëtares U17, Erion Kajtazi, i cili të shtunën ndërroi jetë në fushën e gjelbër, pas një ataku në zemër. Erioni u përcoll mes lotësh e dhembjesh jo vetëm nga familja, por edhe të gjithë ata që ishin të pranishëm në ceremoninë e varrimit. Presidenti Agim Ademi në

fjalën e tij emocionuese theksoi se ikja e hershme e Erionit është një dhembje e madhe për familjen dhe humbje e madhe për futbollin e Kosovës, pasi ai vlerësohej si njëri prej lojtarëve më të talentuar të gjeneratës së tij dhe i gatshëm për të bërë karrierë në futbollin evropian.

